



KPM-2019/01

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6 dhe 2.11 si dhe nenit 26, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM miraton:

RREGULLORE PËR MBËSHTETJEN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE ME MBULIM TOKËSOR LOKAL DHE REGJIONAL

NENI 1 QËLLIMI

Kjo Rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve nga Fondi i KPM-së dhe mënyrën se si duhet të përdoren këto mjete. Qëllimi i ndarjes së mjeteve nga Fondi i KPM-së është që t'u ofrohet mbështetje ofruesve të shërbimeve mediale me qëllim të promovimit të programeve cilësore të shumëllojshme në interes të publikut.

NENI 2 FUSHËVEPRIMI

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen ndaj të gjithë të licencuarve të KPM-së të cilët ushtrojnë aktivitete të ofrimit të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale me mbulim tokësor lokal dhe regjional në Republikën e Kosovës.

NENI 3 PËRKUFIZIMET

- Ofrues i shërbimit medial audiovizual (OSHMA)** – personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuale të ofruesit të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.
- Fondi për mbështetje** - (në tekstin e mëtejshëm: Fondi) është shuma e mjeteve e grumbulluar nga të hyrat nga tarifa vjetore e licencës dhe donacione tjera të dedikuara për mbështetje në formë të granteve për OSHMA-të.
- Grant programor** - Mbështetja financiare për një projekt me aktivitete specifike programore, të detajuara në aplikacionin për grant, me rezultate të matshme përfundimtare.
- Aplikacioni për grant** - Formulari në formë pyetësi i dedikuar për plotësim me informata relevante rreth projekt propozimit për të cilin kërkohet mbështetja financiare.

5. **Përfitues i grantit**- i licencuari i cili i përmbush kriteret për financim të projektit dhe nënshkruan kontratën për financim me KPM-në.
6. **I licencuar** - personi juridik të cilit KPM-ja i ka dhënë Licencën për të operuar si ofrues i shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.
7. **Parashtruesi i kërkesës** – i licencuari i KPM-së, me mbulim tokësor lokal dhe regional, që aplikon për grant programor.
8. **Komisioni vlerësues** – komisioni i caktuar nga KPM për vlerësim të aplikacioneve dhe përpilim të rekomandimit të listës së përfituesve të Fondit.

NENI 4 SIGURIMI I TË HYRAVE

1. Mjetet e Fondit të KPM-së sigurohen nga shuma e përgjithshme e tarifës vjetore të licencës, siç është e përcaktuar me Rregulloren përkatëse të KPM-së për nivelin e tarifës vjetore për licencë.
2. Përqindja e shumës së përgjithshme të tarifës vjetore të licencës që do të përdoret për këtë Fond do të përcaktohet me vendim të KPM-së.
3. Ky fond mund të plotësohet me donacione dhe të interesuarit e tjerë për kontribute dhe mbështetje financiare, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

NENI 5 NDARJA E FONDEVE

1. Ndarja e mjeteve nga Fondi bëhet përmes:
 - 1.1 granteve programore për mbështetje të ofruesve të shërbimeve mediale me qëllim të promovimit të programeve cilësore të shumëllojshme në interes të publikut.
2. Ndarja e mjeteve nga Fondi bëhet në pajtim me parimet e mëposhtme:
 - 2.1 liria, profesionalizmi dhe pavarësia e OSHMA-ve;
 - 2.2 ndalimi i censurës;
 - 2.3 qasja e lirë dhe e barabartë në mjetet e Fondit;
 - 2.4 zhvillimi i konkurrencës, pluralizmit dhe përmbajtjeve programore cilësore;
 - 2.5 objektiviteti, ndalimi i diskriminimit dhe transparenca.

